



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

PML.nr.259/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar, Valdete Daka dhe Mejreme Memaj, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Mirlinda Mejzini-Simnica, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit A. M., nga Gj., për shkak të veprës penale keqpërdorim i besimit nga neni 342 par.2 të KPK, duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit, ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, P.nr. 95/2022 datë 22.02.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti i Përgjithshëm, PA1.nr.596/2023 datë 21.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 16 maj 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Me miratimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit A. M., **NDRYSHOHET**, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, P.nr. 95/2022 datë 22.02.2023 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti i Përgjithshëm, PA1.nr.596/2023 datë 21.02.2024, bazuar në nenin 363 par . 3 nënpar.1.3 të KPPK, dhe i pandehuri A. M., me shënime personale si në shkresa të lëndës :

LIROHET NGA AKUZA

Se, prej datës 03.02.2017 deri më datë 06.03.2017, në kohë të pacaktuar, në Gj., në cilësi të avokatit të autorizuar të dëmtuarit H. L., i autorizuar sipas autorizimit të noterizuar ... të datës 03.02.2017, të dhënë nga i dëmtuari, gjatë përfaqësimit apo kujdesit për interesat pasurore të personit tjetër nuk i përmbush detyrimet e tij ose i keqpërdor autorizimet e tij me qëllim që vetes apo personit tjetër t'i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme apo t'i shkaktoj dëm personit interesat pasurore të te cilit ai i përfaqëson ose pasuria e te cilit është nën kujdesin e tij, në atë mënyre që pranë Gjykatës Themelore në Gjakovë, në çështjen e shqyrtimit të trashëgimisë së të ndjerit T. L.-babai i të dëmtuarit, më numër të rastit T.nr.6/16 datë 03.02.2017, ndërpritet procedura e trashëgimisë, ku i dëmtuari udhëzohet nga ana e gjykatës, që në afat prej 30 ditësh, të inicioj procedurën kontestimore

si palë më e dobët në relacion me trashëgimtarët tjerë dhe të njoftojë gjykatën me një kopje të padisë për inicimin e saj, me paralajmërim se nëse nuk iniciohet procedura në afatin e cekur , atëherë gjykata do të vazhdoj procedurën trashëgimore me të dhënat që i ka në dispozicion. I pandehuri nuk e inicion procedurën kontestimore në afatin e paraparë të dhënë nga gjykata, me datën 20.07.2017 parashtron padi por pas afatit 30 ditor, ndërsa ndaj aktvendimit të trashëgimisë të Gjykatës Themelore në Gjakovë T.nr.5/2016, datë 18.07.2017. parashtron ankesë e cila refuzohet nga Gjykata e Apelit të Kosovës me aktvendim AC.nr.4495/2017 datë 22.06.2020, me të cilat veprime të dëmtuarit i shkakton dëm material,

-me çka kishte për të kryer veprën penale keqpërdorimi i besimit nga neni 342 par.2 të KPK.

II.Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

III.I dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore –juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, P.nr. 95/2022 datë 22.02.2023, i pandehuri A. M. , është shpallur fajtor për shkak të veprës penale keqpërdorim i besimit nga neni 342 par.2 të KPK dhe i është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë)muaj i cili dënim me pëlqim të dënuarit i është zëvendësuar me dënim me gjobë në lartësi prej 1500(njëmijepesëqind) €, të cilën është obliguar ta paguaj në 3(tri) këste mujore të barabarta, duke filluar nga data 01-05 e muajit pasues pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Nëse dënimin e shqiptuar me gjobë i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mundet ta paguaj, atëherë gjykata , do t’ia me dënim me burgim ,duke ia llogaritur 20(njëzetë)€ gjobë për një ditë burgim , gjithsejtë 75 ditë burgim.

I pandehuri është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor dhe të shpenzimeve gjyqësore, të paguaj shumën 30(tridhjetë)€ dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimet shumën prej 30(tridhjetë)€, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, e nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

I dëmtuari H. L. ,për realizimin e kërkesës pronësore –juridike , është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit të Kosovës-Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin, PA1.nr.596/2023 datë 21.02.2024, ka refuzuar ankesën e mbrojtësit të pandehurit A. M., ndërsa aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë të mbrojtjes së ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të pandehurit A. M., avokat Teki Bokshi ,nga Gj., për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale me propozim që aktgjykimet e atakuara të ndryshohen dhe i dënuari të lirohet nga akuza.

Prokuroria e Shtetit të Kosovës, me parashtrësën KMLP.II.nr. 144/2024 datë 25.04.2024, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e ushtruar nga mbrojtësi i të pandehurit.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPP-së, vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe konstatoi:

-kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është e bazuar.

Në kërkesë, mbrojtësi i të pandehurit, pretendon se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 369 par.6 dhe 7 të KPPK, ngase se arsyetimi për faktet vendimtare është i mangët dhe kanë dështuar të argumentojnë faktet kryesore fajësuese .Në fakt arsyetimi i aktgjykimit të shkallës së parë i vërtetuar me aktgjykimin e shkallës së dytë , është vetëm një përshkrim i procesverbaleve dhe deponimeve të palëve ,pa dhënë ndonjë shpjegim dhe analizë lidhur me elementet e veprës penale. Duke pasur parasysh se elementi qenësor i veprës penale keqpërdorimi i besimit nga neni 342 par.2 të KPK, është “qëllimi që vetes apo personit tjetër t’i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme apo t’i shkaktoj dëm personit , interesat pasurore e të cilit ai i përfaqëson apo pasuria e të cilit është nën kujdesin e tij”, i cili element ,pra qëllimi, nuk është argumentuar dhe nuk janë dhënë arsye lidhur me këtë fakt. Pra mungon dashja direkte , si element qenësor i kësaj vepre penale .Andaj del se edhe ligji penal është aplikuar në dëm të pandehurit kur është shpallur fajtor.

Gjykata Supreme , duke vlerësuar pretendimet nga kërkesa si dhe bazuar në shkresat e çështjes gjen se aktgjykimet janë të janë të përfshira me shkelje të ligjit penal në dëm të pandehurit e nga arsyet si më poshtë:

-nga shkresat e çështjes del se ,qëndron fakti se i pandehuri, gjatë ushtrimit të detyrës së tij si avokat-përfaqësues i të dëmtuari H. L. , në një çështje të trashëgimisë pranë Gjykatës Themelore në Gjakovë, nuk e kishte ushtruar një mjet juridik sipas udhëzimit të gjykatës, në fakt e kishte ushtruar me vonesë.

Megjithatë , nga arsyetimi i aktgjykimit të shkallës së parë ,nuk mund të vërtetohet se i pandehuri e kishte lëshuar afatin me qëllim që të dëmtuarit t’i shkaktoj dëm apo t’i sjellë vetit apo personit tjetër dobi pasurore, e që është element qenësor i kësaj vepre penale. Kjo nga fakti se nga provat e administruara në shqyrtim është vërtetuar vetëm fakti se i pandehuri si i autorizuar i të

dëmtuarit , e kishte lëshuar afatin për ushtrimin e një padie për inicimin e procedurës kontestimore si palë më e dobët në relacion me trashëgimtarët tjerë , në afatin gjyqësor prej 30 ditësh, të përcaktuar nga gjykata dhe se gjykata në mungesë të padisë së tillë kishte vazhduar procedurën me të dhënat që i kishte. Po ashtu , nga shkresat nuk është e çështjes , nuk është vërtetuar se i pandehuri këtë lëshim të afatit nuk e kishte bërë me qëllim apo dashje që të dëmtuarit t'i shkaktoj dëm apo t'i sjellë vetit apo personit tjetër dobi pasurore, sepse nga provat e vlerësuara ky fakt nuk është argumentuar.

-duke u nisur nga fakti se për të ekzistuar vepra penale keqpërdorimi i besimit nga neni 342 par.2 të KPK, duhet të plotësohen dy kushte dhe atë kumulativisht, pra të ekzistoj qëllimi respektivisht dashja e drejtpërdrejtë dhe përfitimi material për vete apo për tjetrin apo shkaktimi i dëmit për të dëmtuarin , si dhe duke u nisur nga fakti se gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur që t'i argumentoj këto fakte, ndërsa gjykata e shkallës së dytë nuk ka arritur që këto të meta t'i evitoj as sipas detyrës zyrtare , rrjedh se i nuk është vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën edhe është shpallur fajtor.

Andaj , me të drejtë potencon mbrojtësi i të pandehurit, se në dëm të njëjtit është shkel ligj penal kur është shpallur fajtor dhe kjo gjykatë në mbështetje të nenit 438 par.1 të KPPK, ka ndryshuar aktgjykimet dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

PML.nr.259/2024, më 16 maj 2024

Procesmbajtësja,
Mirlinda Mejzini-Simmica

Kryetari i kolegjit,
Agim Maliqi